



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"
Bordi i Administrimit

Nr. 111 Prot

Shkodër, më 20 . 02 .2020

V E N D I M

Nr. 110 , datë 20.02 .2020

**"PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ADMINISTRIMIT
NR. 277, DATË 14.08.2019"**

Në mbështetje të Ligjit nr. 80, dt 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 3, pika 3/ç, neni 6 pika 30, neni 38, 49; VKM-së nr. 288, datë 21.05.2018 "Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në Institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë", (i ndryshuar me VKM nr. 723, datë 06.12.2018, si dhe VKM nr 778, datë 26.12.2018), Statutit të USH-së i vitit 2018, neni 5, neni 17, pika 6/nj; neni 28, rregullores së studimeve të universitetit miratuar me vendimin e SA nr182, datë28.05.2019, vendimit të Senatit Akademik nr. 253, datë 17.07.2019, vendimit të Bordit të Administrimit nr.277 datë 14.08.2019 "Për miratimin e tarifës vjetore të shkollimit në programet e ciklit të parë dhe të dytë të studimeve me kohë të plotë, për vitin akademik 2019 – 2020, shkresës nr. 1036 prot datë 06.02.2020 të MASR "Mbi zbatimin e VKM nr.788 datë 26.12.2018, Bordi i Administrimit në mbledhjen e tij të datës 18.02.2020,

Vendosi

1. Të ndryshojë, për efekt zbatimi, që përfitues të reduktimit në masën 50% të tarifës vjetore të shkollimit, në ciklin e parë të studimeve do jenë ata studentë të cilët rezultojnë me notë mesatare të ponderuar mbi 6. Tek kjo mesatare do të llogariten edhe notat negative 4 (katër) si dhe provimet që nuk frekuentohen, do të llogariten si notë pakaluese 4 (katër).
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETARI I BORDIT

